PROÇESVERBAL I PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE.

Datë 25 gusht 2025 ora 10:00

Salla e Këshillit Bashkiak

KËSHILLTARE E.Mitre: Përshendetje ju falenderoj që  jeni prezent në këtë takim, në emër të komisionit të mirëqënies sociale, barazisë gjinore dhe kryesisë të Këshillit bashkiak, ky është një dokumëent strategjik e cila do përcaktojë analizën e situatës, planin e veprimit, struktura përgjegjëse, kostot e përafërta për përmirësimin e gjendjes, takimi i sotëm rregjistorhet që na shërben edhe ne në mbledhje, fjalën po ja jap zonjës Mariana Lara për prezantim dhe më pas mund të bëni pyetje ose propzoime.

Marjana Lara: Faleminderit që u bëtë pjesë e këtij takimi, ky është plani i dytë për drejtorinë e kujdesit social ky është një plan i buxhetuar 2025-2030, pani i parë nuk ka qënë është përgatitur në kuadër për barazinë gjinore por edhe kartës Europiane pë grad he burra, kartë e cila është miratuar nga Bashkia e Korçës në vitin 2016. Unë do bëj një prezantim të plait. Ky plan është parimor për demokracinë, nga ana e Bashkisë jemi të vetëdijshëm për rolin që luajnë femrat, burrat në diversitetin e tyre, për sa i takon respektimit të të drejtave të njeriut. Ky plan është si një rezultat i një procesi të hapur dhe konsultues I ndërtuar mbi partneritet, ne kemi zhvilluar disa seanca konsultuese ku kanë qënë pjesë partnerë të ndryshëm ndërkombëtar, ky plan ka pasur mbështetje edhe shoqërinë civile.  Ky plan parashikon fuqizimin e grave dhe të rejave, rritjen dhe përfaqësimin e tyre në vendimmarrje, zhvillimin e kapaciteteve instutcionale për buxhetim të përgjithshëm gjinor. Ky plan përmban kuadrin ligjor, metodologjinë, fushat e ndërhyrjes. Ky plan u hartua nga Bashkia e Korçës si mjet kryesor për angazhimin politik, publik për barazinë gjinor. Ky plan u hartua për një process ndërveprues gjithëpërfshirës duke patur parasysh instiucionet, organizatat, aleancën e grave dhe këshilltarët e Këshillit bashkiak. Kemi 4 shtylla të hartimit të planit:

- Promovimi I të drejtave ekonomike, sociale dhe punësimit të denjë, fuqëzimi i grave.
- Rritja e pjesëmarrjes të të rejave dhe të rinjve në gjithë diversitetin në nivelin vendor.
- Liri nga të gjitha format ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.
- Integrimi gjinor në politikat vendore.

Disa nga objektivat janë: RRitja e grave dhe të rejave në gjithë diveristetin e tyre ndaj burimeve finaciare që ndikojnë në situatën ekonomike të tyre, pavarsisht races, besimit fetar që mund të kenë. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike dhe publike në nivel vendor. Fuqëzimi dhe rritja e efikasitetit të mekanizmit të referimit kundër dhunës në familje. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore,  praktikave të dëmshme, diskriminimi përmes edukimit të shoqërisë me barazinë gjinore. Matricat e palnit vendor, për çdo masë, aktivitet të parashikuar dhe endekun financiar. Nga përllogaritjet e bëra për këtë plan 2025-2030 rezulton se kostot në tërësi janë 44 milion e 66 mijë 362 lekë por kjo është e ndarë 35 milion e 279 e 876 lekë që mbulohen nga Bashkia, me stafin ekzistues dhe me kontirubut në natyrë që i ka vënë në dispozicion, 765 mijë e 104 lekë janë kosto që mbulohen për moemntin nga donatorë të ndryshëm dhe 8 milion e 23 mijë e 882 lekë

janë hendeku financiar për të cilat ne do lobojmë për gjetjen e burimeve financiare ose do bëhen planifikimet shtesë në PBA në vitet e ardhshme ose do gjenden nga donatorë apo palë e tretë. Procesi i raportimit do kryhet nga drejtoria apo sektori përgjegjës për zbatimin e aktivitetit tek komisioni i mirëqënies sociale, grupi do ngrihet direkt pas miratimit të planit me përfaqësues nga secila drejtori, raportimet do jenë periodike çdo 6 muaj.

KëSHILLTARE E.Mitre: Meqënëse Marjana u fokusua tek aktivitetet mund të dimë disa aktivitete konkrete?
Marjana Lara: E para unë dua t'ju qartësoj se Bashkia ka bërë hap përsa i takon integrimit gjinor në fillim ka filluar me marrjen në punë të një specialist dhe kordinatorin kundër dhunës dhe barazinë gjinore para dy vitesh kemi marrë dhe specialiatin për barazinë gjinore, fushata ndërgjegjësimi jo vetëm nëpër shkolla, aktivitet  i bëjmë bashkë nëpë gjitha instiucionet. Kemi dy javët siç janë 25 nëntor-10 dhjetor, dy javë që janë javë ndërgjësuese, janë aktivitete që bëhen çdo ditë kundër dhunës, kemi bashkëpunuar ngushtë me gjithë aktorët. Në fshatin Vidhkuq dhe Poelnë kemi grupe grash që bëjnë produktet e tyre sidomos zahiretë për pjesën e dimrit, kemi pasur si Bashki vitet e para me grate e Polenës edhe Eva është në dijeni sepse kemi qënë së bashku për implementimin e këtij projekti. Informimi i rregullt i grave dhe burave për mbështetjen që ofrojmë nga Ministria e Buqësisë. Unë disa ju përmenda nëse ju keni ndonjë sygjerim që mund të shtojmë ndonjë aktivitet.

Këshilltare A.Taho: Në fakt të gjitha aktivitetet janë shumë të detajuara, unë me disa anëtarë të komisionit kemi qënë pjesë të hartimit të këtij plani dhe unë dua ta falenderoj zonjën për mbështetjen. Ajo që unë dua ta filloj disutimin është se shoh se ka anëtarë të organizatave dhe hyj tek ajo pjesa e fundit që do na duhet që të gjitha këto aktivitete të kemi mundësi që së bashku t'i shtojmë këto aktivitete, kemi mundësi të diskutojmë me organizatat përkatëse.

Qytetaria: Unë e dëgjova me vëmendje dhe do doja të dija sa efikase do jetë ligji në këtë rast, projektligji?
Sepse ligji mund të ekzistojë por ka disa probleme që nuk raportohen duhet të kemi më shumë sensibilizim, edhe mediat sot duhet të ishin që të dëgjohej më shumë. Unë quhen Katerian Spirollari dhe banjo në Tirane.

KëSHILLTARE E.Mitre: Ju nga e keni marrë informacionin?

Qytetaria: Unë jam vazhdimisht me telefon në dorë dhe Këshillin e ndjek, unë jam e fokusuar tek ligjet më shumë sepse ato shruhen por nuk raportohen dhe shqetësimi im këtu qëndron tek raportimin. Projektin e kam parë me shumë detaje, te treja temat, por këtu tek ligjet e kisha nuk e di sa do jenë të aksesueshme, jo vetëm për grate por edhe burrat.

Marjana Lara: Ne planin e kemi ndërtuar mbi një strategji kombëtare, mbi Kartën Europiane, janë planet e veprimit për Barazinë gjinore, kuadrin ligjor për mendimin tim është shumë i mirë ne duhet të përshatemi.

Qytetaria: Duhet të promovohet ligji edhe plani që keni hartuar, të jenë më shumë të sensibilizuar jo vetëm ne.

Marjana Lara: Po edhe ne këtë thamë që detyra jonë është ndërgjegjësimi.

Qytetaria: Shumë shkruhen, por shumë pak zbatohen dhe pastaj vijmë në një pikë që e zgjidhim me gjykata.

Marjana Lara: Qëndrojmë tek ligjet, çdo bazë ligjore ne e zbatojmë.

KëSHILLTARE E.Mitre: Nëse ju e keni lexuar me vëmendje atje ishte gjithë baza ligjore.

Qytetaria: Dua të them se jo çdo gjë ta lemë në dorë të gjykatave, duhet të ndërgjegjësojmल më shumë.

Qytetaria 2: Quhem Entela Maçka dhe jam përfaqësuese e Shoqatës “Gruaja në Zhvillim” , unë e lexova dhe është një dokument i hartuar shumë mirë me indikatorë, është përcaktuar dhe buxheti që do jetë në dispozicion, i orentuar shumë mirë, është një bazë shumë e mirë edhe për shoqërinë civile sepse mund të shërbejë si një bazë, sepse planin vendor shikohet në makro, ka orientime shumë të mira ku mund të mbështetemi në të ardhme. Unë do thoja diçka tek forcimi i dimensionit parandalues dhe ndërgjegjësimi ndoshta këtu duhet të vihej theksi pak më tepër për veprime orientuese më tepër për të parë disa lloj ndërhyrjesh dhe veprimesh që nuk janë bërë më parë sepse e dimë vit për vit bëhet fushata kundër dhunës që janë ditët portokalli por ndoshta këtu mund të kemi diçka më tepër për ndergjëgjësimin e komunitetit për të ndryshuar mentalitetin.

Qytetaria 1: Këtë po thoja dhe unë.

Qytetaria 2: Unë kam qënë pjesë e hartimit të këtij plani dhe mesa po shoh të gjitha sygjerimet që kemi dhënë janë marrë parasysh, ne kemi bërë më parë dhe aktivitete informuese, ndërgjegjësuese me grupe të ndryshme, kemi bërë aktivitete të ndryshme edhe nëpër shkolla së bashku me barazinë gjinore, nuk ka qënë vetëm me vajza por edhe me të rinj të cilët janë informuar dhe ndërgjegjësuar me gjithë veprimtarinë e institucionit tonë. Duhet të shtoj diçka tek plani në lidhje me punësimin ose me pjesën e vendimmarrjes duhet të kemi më tepër bashkëpunim me institucionin dhe me organizatat e shoqërisë civile ku duhet të ndërgjegjësojmë vetë të rinjtë sin ë rregjistrimin e arsimit profesional, atij të mesëm dhe vazhdimin e punësimit të tyre. Më vjen mirë që institucioni i punësimit është një shtysë që ju jep më tepër për vazhdimësinë e këtyre komuniteteve dhe ndërgjegjësimin e tyre.

KëSHILLTARE E.Mitre: Ka ndonjë sygjerim tjetër?

Marjana Lara: Nëse nuk ka diçka  embyllim, faleminderit që ishit pjesë e këtij takimi!

**Përmbledhje e rekomandimeve :**

Qytetaria: Unë e dëgjova me vëmendje dhe do doja të dija sa efikase do jetë ligji në këtë rast, projektligji?
Sepse ligji mund të ekzistojë por ka disa probleme që nuk raportohen duhet të kemi më shumë sensibilizim, edhe mediat sot duhet të ishin që të dëgjohej më shumë. Unë quhen Katerian Spirollari dhe banoj në Tirane.

Qytetaria 2: Quhem Entela Maçka dhe jam përfaqësuese e Shoqatës "Gruaja në Zhvillim" , unë e lexova dhe është një dokument i hartuar shumë mirë me indikatorë, është përcaktuar dhe buxheti që do jetë në dispozicion, i orentuar shumë mirë, është një bazë shumë e mirë edhe për shoqërinë civile sepse mund të shërbejë si një bazë, sepse planin vendor shikohet në makro, ka orientime shumë të mira ku mund të mbështetemi në të ardhme. Unë do thoja diçka tek forcimi i dimensionit parandalues dhe ndërgjegjësimi ndoshta këtu duhet të vihej theksi pak më tepër për veprime orientuese më tepër për të parë disa lloj ndërhyrjesh dhe veprimesh që nuk janë bërë më parë sepse e dimë vit për vit bëhet fushata kundër dhunës që janë ditët portokalli por ndoshta këtu mund të kemi diçka më tepër për ndergjëgjësimin e komunitetit për të ndryshuar mentalitetin.

Unë kam qënë pjesë e hartimit të këtij plani dhe mesa po shoh të gjitha sygjerimet që kemi dhënë janë marrë parasysh, ne kemi bërë më parë dhe aktivitete informuese, ndërgjegjësuese me grupe të ndryshme, kemi bërë aktivitete të ndryshme edhe nëpër shkolla së bashku me barazinë gjinore, nuk ka qënë vetëm me vajza por edhe me të rinj të cilët janë informuar dhe ndërgjegjësuar me gjithë veprimtarinë e institucionit tonë. Duhet të shtoj diçka tek plani në lidhje me punësimin ose me pjesën e vendimmarrjes duhet të kemi më tepër bashkëpunim me institucionin dhe me organizatat e shoqërisë civile ku duhet të ndërgjegjësojmë vetë të rinjtë sin ë rregjistrimin e arsimit profesional, atij të mesëm dhe vazhdimin e punësimit të tyre. Më vjen mirë që institucioni i punësimit është një shtysë që ju jep më tepër për vazhdimësinë e këtyre komuniteteve dhe ndërgjegjësimin e tyre.

**Sekretari i Këshillit**

**Eva Naçi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# Listëprezenca e konsultimit

## "PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030"

**Takim datë 25.07.2025 ORA 10:00**

| NR. | EMËR, MBIEMËR | E-MAIL | NËNSHKRIMI |
|---|---|---|---|
| 1 | Eleni Cule | eleni_cule@unwomen.org | |
| 2 | Paola Lara | paola.lara@[illegible].gov.al | |
| 3 | Etleva Tare | Etleva.Tare@[illegible].al | |
| 4 | Margena Zonja | margenagusho@gmail.com | |
| 5 | Jelda Melka | [illegible]@gmail.com | |
| 6 | Gabunda Hoska | gabundahoska.22@gmail.com | |
| 7 | Isida Bicolli | isidabicolli@yahoo.com | |
| 8 | Matilda Noka | matilda.noka@[illegible].gov.al | |
| 9 | Kentela Macka | widkentela@yahoo.it | |
| 10 | Helena Zhapa | helenazhapa@hotmail.com | |
| 11 | Ado Permeti | ado.permeti@gmail.com | |
| 12 | Mirela Balli | mirelaballi@bashkia.gov.al | |
| 13 | Dhurata Mehmeti | dhurata.mehmeti@asp.gov.al | |
| 14 | Joniada Romacka | joniadaromacka@yahoo.com | |
| 15 | Lorena Voko | [illegible] | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 16 | Ornela Alliu | ornela.a@yahoo.com | [signature] |
| 17 | Arxhela Toho | toho.arxhela@gmail.com | [signature] |
| 18 | Erion Dolleku | e.dolleku@emanuelmission.org | [signature] |
| 19 | Françeska Voushi | franceskavoushi@gmail.com | [signature] |
| 20 | Joana Tenepexli | joanatenepexli23@gmail.com | [signature] |
| 21 | Xheni Bimbli | zhgabax@gmail.com | [signature] |
| 22 | Gona Spahillari | Gionaspahillari@gmail.com | [signature] |
| 23 | Sara Canka | cankasara97@gmail.com | [signature] |
| 24 | Katerina Spiroddri | Spdri.Katerina@gmail.com | [signature] |
| 25 | Anxhela Dishnica Qeparixi | anxhela.dishnica@bashkiakorce.gov.al | [signature] |
| 26 | Denada Tasolu | denada.tasolu@bashkiakorce.gov.al | [signature] |
| 27 | Mariane Jorgji | mariane.lara_tth@yahoo.com | [signature] |
| 28 | Edlira Mitre | edamitre@yahoo.com | [signature] |
| 29 | Enkelejda Manka | bicienkelejda4@gmail.com | [signature] |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |


Plani Vendor i Barazisë
Gjinore




Gjinore


Plani Vendor i Barazisë
Gjinore


Gjinore

